



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosova

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA

Raporti për Periudhën Janar – Prill 2018

Hartues: Besnik Beka – Zëvendësministër, në Ministrinë e Zhvillimit
Ekonomik.



Përmbajtja :

Hyrje.....	3
Takimet për hartimin e Statutit të Trepcës.....	3
Takime të rregullta me Partneritetin Publiko Privat	5
Mbledhjet me Qeverinë e Kosovës.....	6
Raportim në Komisionin FunkSIONAL.....	8
Përfundimi	9



Hyrje :

Fillimisht do të bëjë një sqarim lidhur me mandatin tim. Unë jam emëruar zëvendësiministër në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), më 31.10.2017. Ndërsa raporti është hartuar për periudhën Janar – Prill 2018, me kërkesë të Kryeministri z.Ramush Haradinaj.

Në kuadër të këtij raporti janë paraqitur aktivitetet kryesore që kam kryer, si zëvendësiministër në tre (3) mujorin e fundit.

Raporti në fjalë përfshinë pjesëmarrjen time në takime e mbledhje të ndryshme, duke sqaruar pikat kyçe si (rezultatet, vendimet, konkluzionet, temat), që janë elaboruara në takime. Në cdo pikë të shtjelluar më poshtë, do të gjeni edhe të dhënat për mbarvajtjen dhe rolin tim në këto mbledhje.

Takimet për hartimin e Statutit të Trepçës

Në cilësinë e zëvendësiministrit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, kam qënë Kryetar i Grupit punues për hartimin e Statutit të Trepçës.

Ky komision është përbërë nga disa anëtarë, ashtu sic e parasheh edhe ligji, ku nga Ministria të cilën unë përfaqësoj, pjesëmarrës ishim unë si Kryetar dhe Këshilltari i lart Politik z.Ibrahim Rexhepi. Mbledhjet kanë qënë të rregullta, më datat si në vijim:

- 01.02.2018
- 06.02.2018
- 13.02.2018
- 15.02.2018

Në cdo mbledhje, iu dha fjala secilit nga anëtarët për të shprehur mendimin, dhe për të dhënë sygjerimit e tyre lidhje më hartimin e Statutit të Trepçës.

Gjatë takimeve janë marrur në konsiderat të gjitha të dhënat, që anëtarët e këtij Grupi ofronin, me qëllim që Statuti i Trepçës të gjej zbatueshmëri pas aprovimit të tij.

Në njërën nga mbledhjet e mbajtura, konkretisht në takimin e datës 06.02.2018, Grupi Punues doli me një draft për Statutin (i cili nuk ishte përfundimtar), pasi që ishte e domosdoshme të bëheshin edhe korrigjime të tjera, duke pasur për bazë Ligjin 05/L/120 mbi Statutin e Trepçës. Në këtë draft (jo përfundimtar) mbetën të hapur për përmiresim dhe plotësim *nenet* e mëposhtme:



Neni 13:

- Duhet të bëhej plotësimi i këtij neni.

Neni 14:

- Kjo pikë e Statutit duhet të rregullohet, pasi të nxiret akti nënligjor i *nenin 4*, paragrafi 4 i ligjit për Trepçën.

Në mbledhjen e radhës, të datës 13.02.2018, Grupi punues, diskutoi rreth përmbajtjes së Statutit të Trepçës, me c'rast bëri disa plotësime në disa *nene* dhe disa çështje mbetën për diskutim sic janë:

Neni 10:

- Aksionet, kjo duhet të rregullohet në momentin e hartimit dhe miratimit të aktit nënligjor për mënyrën e ndarjës së aksioneve, kjo sipas Ligjit për Trepçën

Neni 11:

- Veprimtaria , të pranuar nga ARBK , si dhe disa të tjera nga Trepca(a duhet të jenë të gjitha te përfshira apo vetëm ato të cilat janë të regjistruara).

Neni 13:

- Informata nga ARBK , Kapitali i përgjithshëm

Neni 17 :

-Paragrafi 12 i cili paragraf specifikon që të të gjitha vendimet me rëndësi si ndryshimi i statutit , emërimin , largimin apo zëvendësimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe çështje tjera të përcaktuara në këtë nen, duhet të kërkojnë votën e shumicës.

Takimin e radhës të mbajtur me Grupi punues më 15.02.2018, u diskutuna të gjitha pikat e rendit të ditës (të mbetura edhe nga mbledhja e kaluar), duke përfshirë analizimin e cdo *neni* të këtij Statuti. Si produkt final i këtij takimi, doli edhe drafti përfundimtar (final) mbi Statutin e Trepçës, i cili pas marrjës së miratimit të të gjithë anëtarëve të Grupit punues, u dërgua për lektorim, pastaj të vazhdohet në procedurat vijuese.



Takime të rregullta me Partneritetin Publiko Privat

Takimet e rregullta me Komitetin për Parteniritet Publiko Privat, kanë qenë të inicuar nga vet Ministri i Financave, z.Bedri Hamza. Në këto takime unë isha i ftur si anëtarë i Komitetit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).

Në vazhden e takimeve si temë kryesore e diskutimit ishte analizimi i zhvillimit të politikave të Partneritetit Publiko Privat (P.P.P).

Në takimin e datës 1 dhjetor 2017, në agjend ishte paraparë të diskutohet:

1. Konfirmimi i kuorumit;
2. Njoftim mbi rolin dhe përgjegjësitë e Komitetit të PPP;
3. Njoftim dhe shqyrtim i propozim-ndryshimeve në Rregulloren e Punës së Komitetit për PPP;
4. Propozim plani strategjik i DQPPP;
5. Njoftim mbi projektet e aprovuara nga Komiteti i PPP;
6. Propozim për pikat e rendit të ditës të takimit të radhës;
7. Çështje tjera.

Ashtu siç theksohet në *Nenin 10*, të rregullorës së punës së Komitetit për Partneritet Publiko Privat ("KPPP"), fillimisht u dëgjua raportimi mbi ecurin e zbatimit të vendimeve të KPPP, nga Drejtori i Departamentit Qëndror për PPP.

Në takim ndër të tjara, u bë shqyrtimi i projekteve të zhvilluar me procedurën e Partneritetit Publiko Privat, ku vlen të theksohet se një numër i konsiderueshëm i projekteve të hartuar, janë të pa realizueshme, për arsye të procedurave që parashihen me ligjet përkatëse.



Pjesëmarrje në mbledhjet e Qeverisë

Në mbledhjen e 26 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbajtur më 29.01.2018, në pamundesi të pjesëmarrjes së Ministrit Lluka në këtë mbledhje , u dakorduar që nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të marrë pjesë unë.

Në rend ditë ishin:

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet 20, 21,22,23 dhe 24 të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM).
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencise Austriake për Zhvillim (MASHT).
3. Shqyrtimi i Programit për Reforma në Ekonomi 2018 (MF).
4. Shqyrtimi i Projekt-rregullorës për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administratës Publike (MAP).
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Kornisionit për hartimin e Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike (ZKM).
6. Shqyrtimin i Nismes për negociarin e Marrëveshjes së Kredisë për financimin e projektit për ndërtimin e Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Ferizajt (MF).
7. Shqyrtimin Nismës për negociarin e Marrëveshjes së Grantit me Bankert Gjermane për Zhvillim KfË, për financimin e projektit "Programi i sektorit të energjisë (VIII dhe IX) Përmirësimi i ngrohtorës së qytetit në Prishtinë" (MF)
8. Shqyrtimi i Draftit të Koncept Dokumentit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (MD).
9. Shqyrtimi i Draftit të Koncept Dokumentit për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Përfomuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashegimisë Kulturore (MKRS).
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë nr.05/111 të datës 5 tetor 2016 (MPMS).



11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MAP).
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e Ministrit të Financave për transfer të mjeteve nga programi Shpenzimet e Paparashikuara (MF).
13. Të ndryshme.

Pas mbledhjes dhe diskutimeve konform rendit të ditës, u informua edhe Ministri, z.Valdrin Lluka, të cilit i raportova për rrjedhën e mbledhjes dhe vendimeve të marrura.

Gjithashtu, me rastin e vizitës së Kryeministrit z.Ramush Haradinaj në Ministrinë tonë, isha prezent në takimin e planifikuar mes Kryeministrit dhe Zëvendësministrave, ku qëllim i kësaj vizite ishte: të shoh nga afër angazhimin e Ministrisë, dhe të diskutoj rreth planve të kësaj Ministrie.



Raportimi në Komisionin Funksional

Raportim në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal:

Duke e ditur, se raportimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është obligativ në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukture, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.02.2018, isha pjesëmarrës për të raportuar para anëtarëve të këtij komisioni dhe për të ju përgjigjur (shpjeguar) pyetjeve të tyre.

Në këtë mbledhje rend dite ishin:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.02.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L/-040 Për masat Mbrojtëse në Import;
4. Shqyrtimin i Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016;
5. Të ndryshme.

Pika katër (4) e rendit të ditës, është nën përgjegjesin e plotë të Ministrisë që unë përfaqesoj, prandaj edhe bëra raportimin lidhje me Performancën e Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016, duke u bazuar në raportin e brendshëm të Ministrisë.

Ndër të tjera sqarova se:

Bazuar në raportin e vitit 2015 e 2016 del një situatë jo e mirë gati se të të gjitha ndërmarrjet publike.

Arsye janë nga më të ndryshmet, por po ndalem vetëm te disa karakteristika:

- Në vitin 2016 totali i vlerës kontabël të pasurive të NP-ve në pronësi të nivelit qendror është 16.4% më e ulët se në vitin 2015. Të hyrat totale kanë qenë 307 mil. euro apo 7% më pak se vitin paraprak, ndërsa shpenzimet kanë qenë 336 mil euro apo 1.9% më të



larta se vitin 2015. Në total, shpenzimet kanë qenë për 29 milionë euro më të larta se të hyrat;

- Numri i punëtorëve është rritur kryesisht në ndërmarrjet me probleme, përkatësisht ndërmarrjet me rezultate të dobëta financiare. Rënia e numrit të përgjithshëm të punëtorëve të NP-të , kryesisht i referohet shkurtimeve në KEK (475);
- Në asnjërën prej këtyre kompanive që punojnë me humbje nuk janë bërë përpjekje për reduktimin e shpenzimeve. Disa prej tyre kanë humbje në substancë;
- Pagat tregojnë rritje të lehtë;
- Bordet kanë kosto mjaft të lartë. Bonuse janë paguar edhe për bordet e kompanive që punojnë me humbje ;

Më duhet të shtoj se këto raporte i kemi gjetur të gatshme dhe na kanë shërbyer që të kemi pasqyrë më të qartë për gjendjen, si edhe të ndërmarrim masa , me qëllim të krijimit të një disiplinë financiare, e cila duhet të jetë në funksion të një ekonomizimi më të mirë dhe racionalizimit të shpenzimeve.

Jemi të vetëdijshëm se duhet ndërmarrë edhe një sërë masash të tjera, për çka MZHE është duke punuar, si në ndryshimin e legjislacionit ekzistues, ashtu edhe në programin operativ.

Përfundimi:

Përveç aktiviteteve të lart cekura, kam qënë pjesë e Tryezave të ndryshme, si dhe i jam përgjigjur pozitivisht ftesave që më janë bërë si zëvendësministër.

Krahas këtyre, në kuadrin e zbatimit të mandatit ,nuk kanë munguar as takimet dhe mbledhjet mbrenda Kabinetit të Ministrisë, qofshin ato për koordinim të punëve, apo edhe diskutim mbi çështje të tjera.
